

20090050113

L I G J
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR THEMELIMIN E AGJENCISË
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për themelimin Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 72/2007), pas nenit 2 shtohet nen i ri 2-a si vijon:

Neni 2-a

Definicione

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. "Kërkues" është personi juridik ose fizik i cili i paraqet kërkesë dhe dokumentacion adekuat Agjencisë me qëllim të lejimit ose pagesën së përkrahjes financiare nga programet që i realizon Agjencia;

2. "Kërkesë" është formulari i kërkesës së përkrahjes financiare ose kërkesës për pagesë, me dokumentacioni e domosdoshëm për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve për përkrahje financiare, përkatësisht të kriterëve për pagesë;

3. "Marrëveshje bilaterale" janë marrëveshjet e lidhura ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Bashkësive Evropiane, e të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë;

4. "Kontrollim në vendin e ngjarjes" është kontroll i cili bëhet në vendin e ngjarjes nga persona të autorizuar nga ana e Agjencisë;

5. "Kontrollor" është person i autorizuar nga ana e Agjencisë, që bën kontroll në vendin e ngjarjes;

6. "Shfrytëzues" është personi juridik ose fizik të cilit me aktvendim i është lejuar pagesa e përkrahjes financiare;

7. "Koordinator nacional për autorizim" është organi qeverisjes së decentralizuar plotësisht, të cilit i është besuar përgjegjësia e plotë për menaxhimin financiar me mjetet e Buxhetit të EU-së.

8. "Përkrahje financiare" janë mjetet financiare të cilat Agjencia ia lejon, përkatësisht ia paguan shfrytëzuesit."

Neni 2

Në nenin 3 pas paragrafit 2 shtohen dy paragrafë të rinj 3 dhe 4 si vijon:

„Emri i shkurtuar i Agjencisë është APFBZHR.

Emri i Agjencisë në qarkullimin ndërkombëtar është AGENCY FOR FINANCIAL SUPPORT OF AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT."

Paragrafi 3 bëhet paragraf 6.

Neni 3

Neni 5 ndryshon si vijon:

“Puna e Agjencisë bazohet në parimin e ndarjes së kompetencave në kuptim të asaj se çdonjëra nga punët e poshtëpërmendura kryhet nga njësi e veçantë organizative e Agjencisë, edhe atë:

- miratimi i projekteve,
- miratimi i pagesave,
- zbatimi i pagesave,
- kontrolli, dhe
- kontabiliteti.

Në kryerjen e punëve të Agjencisë zbatohen edhe parimet në vazhdim:

- ligjshmëria,
- barazia, paanshmëria dhe objektiviteti,
- profesionalizmi,
- orientimi shërbyes,
- përgjegjësia,
- efikasiteti dhe efektiviteti,
- transparenca,
- e vërteta materiale, dhe
- mbrojtja e interesit publik."

Neni 4

Në nenin 7, paragrafi 1, alineja 7 pas fjalës "regjistri" lidhëza "edhe" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 8 pika zëvendësohet me presje dhe shtohen katër aline të reja 9,10,11,dhe 12, si vijon:

- "-botimi i shpalljeve për paraqitjen e kërkesave për përkrahje financiare,
- lidhja e marrëveshjeve me kërkuessit e përkrahjes financiare,
- kryerja e kthimit të mjeteve, dhe
- punë tjera të përcaktuara me ligj."

Neni 5

Në nenin 8 paragrafi 1 pika në fund zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët : “e veçanërisht me organet e administratës shtetërore kompetente për administrim me punët nga fusha e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, sigurisë së ushqimit, financave, ekonomisë, turizmit dhe hotelarisë e ambientit jetësor."

Neni 6

Në nenin 12 paragrafi 1 pas alinesë 12 shtohet një aline e re 13, si vijon:

- ”-lidh marrëveshje për përkrahje financiare me kërkuessit".

Neni 7

Në nenin 14 paragrafi 2 fjalët: “planet dhe raporti për punën materiale dhe financiare” zëvendësohen me fjalët: “programet për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë”.

Neni 8

Në nenin 18 paragrafi 1 fjalët: "dita e pranimit të kërkesës" zëvendësohen me fjalët: "kalimi i afatit për paraqitjen e kërkesës për përkrahje financiare i përcaktuar në programet për përkrahje financiare, respektivisht shpallje për paraqitjen e kërkesave për përkrahje financiare”.

Në paragrafin 2 fjalët: ”nëse ajo është miratuar me programet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë” fshihen, ndërsa pas fjalës „programet” pika fshihet dhe shtohen fjalët: "për përkrahje financiare."

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3 si vijon:

”Dispozitat nga paragrafi 2 i këtij neni nuk kanë të bëjnë me masat e financuara nga mjetet e Unionit Evropian."

Neni 9

Neni 19 ndryshohet si vijon:

“Nëse kërkesa nga neni 18 paragrafi 1 i këtij ligji është jo e plotë dhe e pakuptueshme, Agjencia e njofton kërkuessin në afat më të shkurtër nga tetë ditë nga dita e pranimit të njoftimit që ta plotësojë ose ta sqarojë kërkesën.

Nëse në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni kërkuesi nuk e plotëson ose sqaron kërkesën do të merret se e njëjta nuk është parashtruar."

Neni 10

Neni 20 ndryshon si vijon:

"Kundër aktvendimeve të Agjencisë nuk lejohet ankesë dhe të njëjtat janë përfundimtare në procedurën administrative.

Kundër aktvendimeve të Agjencisë mund të ngrihet kontest administrativ.

Ngritja e kontestit administrativ nuk e prolongon zbatimin e vendimit."

Neni 11

Neni 21 ndryshohet si vijon:

"Ndarja e përkrahjes financiare me lidhje të marrëveshjes

Nëse është përcaktuar me programet për përkrahje financiare të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, Buxhetit të Unionit Evropian dhe/ose marrëveshjeve bilaterale, Agjencia lidh marrëveshje për përkrahje financiare më kërkuesit të cilëve me aktvendim u është miratuar përkrahja financiare.

Marrëveshjet nga paragrafi 1 i këtij neni lidhen në afat të caktuar nga Agjencia i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, nga dita e pranimit të aktvendimit për miratimin e përkrahjes financiare.

Nëse kërkuesi nuk e nënshkruan marrëveshjen në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni do të merret se ka hequr dorë nga lidhja e marrëveshjes.

Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet të cilat dalin nga marrëveshja e paragrafit 1 të këtij neni aplikohen dispozitat nga Ligji për marrëdhënie obligative, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj ose ligj tjetër.

Pagesa e përkrahjes financiare bëhet pas marrjes së aktvendimit për pagesë nga Agjencia, në afat prej tre muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës për pagesë."

Neni 12

Neni 22 ndryshohet si vijon:

"Përmbajtja e marrëveshjes

Marrëveshja nga neni 21 i këtij ligji përmban në veçanti dispozita për:

- shumën e përkrahjes financiare,
- kohëzgjatjen e marrëveshjes,
- mënyrat dhe afatet për paraqitjen e kërkesë për pagesë,
- obligimet e palëve të marrëveshjes,
- mënyrën dhe procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e saj,
- elemente të tjera për plotësimin e kriterëve, kushteve nga programi për përkrahje financiare ose marrëveshje bilaterale."

Neni 13

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Pagesa e përkrahjes financiare

Agjencia bën pagesën e përkrahjes financiare të masave të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë pas aktvendimit të marrë për miratim dhe pagesë, përveç në rastet nga neni 21 i këtij ligji."

Neni 14

Neni 24 ndryshohet si vijon:

"Mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masa të financuara nga Buxhet i Unionit Evropian, e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Agjencisë."

Neni 15

Pas nenit 24 shtohen dy nene të reja 24-a dhe 24-b si vijon:

"Neni 24-a

Kthimi i mjeteve

Drejtori i Agjencisë miraton aktvendim për kthimin e mjeteve nëse shfrytëzuesi ka marrë përkrahje financiare si rezultat i:

- gjendjes faktike të përcaktuar në mënyrë të parregullt nga ajo që është paraqitur në kërkesë,
- zbatimit të gabuar të dispozitës materiale,
- gabimit administrativ, ose
- mosplotësimit të detyrimeve të marrëveshjeve nga neni 21 i këtij ligji.

Me aktvendimin nga paragrafi 1 i këtij neni shfrytëzuesi hyn në borxh në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të bëjë kthimin e mjeteve.

Nëse vërtetohet së shfrytëzuesi ka marrë përkrahje financiare si rezultat i veprimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia mundet të bëjë kompensimin e mjeteve nëse shfrytëzuesi i plotëson kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare në bazë tjetër në suazat e vitit të njëjtë buxhetor.

Dispozitat nga paragrafi 3 të këtij neni kanë të bëjnë me masat e financuara me mjete nga Buxheti i Unionit Evropian.

Neni 24-b

Agjencia mban Listën e shfrytëzuesve të cilët kanë bërë keqpërdorim të përkrahjes financiare.

Shfrytëzuesit të cilët janë të evidentuar në listë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të parashtrajnë kërkesë për përkrahje financiare në afat prej 2 vjetësh nga dita e evidentimit të listës.

Lista nga paragrafi 1 i këtij neni shpallet në internet faqen e Agjencisë".

Neni 16

Titulli i Pjesës VII "PROCEDURA PËR MIRATIMIN DHE DEDIKIMIN E MJETEVE" shlyhet.

Neni 17

Në nenin 25 paragrafi 2 ndryshon, si vijon:

"Në kërkesë kërkuesi është i detyruar të paraqesë të dhëna dhe dokumente autentike dhe të sakta."

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

"Dispozita nga paragrafi 3 i këtij neni shpallet në internet faqen e Agjencisë."

Neni 18

Në nenin 28 pas paragrafit 1 shtohen dy paragrafë të rinj 2 dhe 3, si vijon:

"Agjencia është e detyruar që në faqen e vet të internetit t'i shpallë shfrytëzuesit e përkrahjes financiare nga Buxheti i Unionit Evropian sipas emrit, komunës dhe lartësisë së mjeteve të cilat u janë paguar në afat prej gjashtë muajsh nga mbyllja e vitit buxhetor në të cilën është paguar përkrahja buxhetore.

Përmbajtjen e të dhënave nga paragrafi 2 i këtij neni në mënyrë të detajuar e përcakton drejtori i Agjencisë."

Neni 19

Pas nenit 29 shtohet nen i ri 29-a, si vijon:

"Neni 29-a

Përpunimi i të dhënave personale

Për shkak të zbatimit të kompetencave të përcaktuara me ligj, Agjencia ka të drejtë të përpunojë të dhëna personale nga kërkuesit, përkatësisht shfrytëzuesit e përkrahjes financiare, si dhe të kërkojë kopje të dokumenteve të tyre personale.

Me kopjet nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia vepron në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale."

Neni 20

Pas nenit 29 titulli Pjesa IX "KONFLIKT TË INTERESAVE" ndryshon si vijon:"KONTROLL NË VENDIN E NGJARJES"

Neni 21

Neni 30 ndryshon, si vijon:

"Kontrolli

Për shkak të vendosjes ndaj kërkesave dhe përcjelljes së plotësimin të detyrimeve të marrëveshjeve të lidhura nga neni 21 të këtij ligji, Agjencia bën kontroll në vendin e ngjarjes përmes kontrollorëve.

Gjatë kryerjes së kontrollit në vendin e ngjarjes, kontrollori doemos duhet të posedojë legjitimacion me të cilin dëshmohet cilësia e tij zyrtare dhe urdhëresë për kryerjen e kontrollit të lëshuar nga drejtori i Agjencisë.

Formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit nga paragrafi 2 i këtij neni, si dhe mënyrën e lëshimit dhe të tërheqjes së tij e përcakton drejtori i Agjencisë."

Neni 22

Pas nenit 30 shtohen dy nene të reja 30-a dhe 30-b, si vijon:

"Neni 30-a

Kompetencat e kontrollit

Agjencia bën kontroll në vendin e ngjarjes te ata persona fizikë apo juridikë të cilët janë kërkues ose shfrytëzues të programeve të përkrahjes financiare për zhvillim rural, të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe Buxheti i Unionit Evropian.

Kërkuesit ose shfrytëzuesit e përkrahjes financiare janë të detyruar të sigurojnë qasje të plotë dhe pa pengesa të kontrollorëve në të gjitha objektet, lokalet, pajisja, prona dhe dokumentacioni që është në lidhje me lëndën e kërkesës dhe marrëveshjen nga neni 21 të këtij ligji.

Të dhënat nga kontrolli i kryer në vendin e ngjarjes shfrytëzohen vetëm për përcaktimin e plotësimin të kritereve për miratim, përkatësisht pagesën e përkrahjes financiare në pajtim me ligjin dhe me marrëveshjen nga neni 21 të këtij ligji. Kontrollori është i detyruar ta ruajë fshehtësinë afariste dhe të gjitha të dhënat që i ka kuptuar gjatë kryerjes së kontrollit.

Nëse gjatë zbatimit të kompetencave të tij të përcaktuara ligjore, kontrollori konstaton se është bërë shkelje e ligjit ose dispozitës tjetër, përkatësisht është bërë kundërvajtje ose vepër penale, është i detyruar që pa prolongim t'i parashtrojë fletëparaqitje organit përkatës kompetent.

Neni 30-b

Afati për zbatimin e kontroleve në vendin e ngjarjes

Kontrolli në vendin e ngjarjes në varshmëri nga nevojat, mund të zbatohet:

- para miratimit të kërkesës për shfrytëzimin e përkrahjes financiare,
- para pagesës si ndihmës financiare, ose

– për kohëzgjatjen e marrëveshjes nga neni 19 të këtij ligji.

Te masat e financuara nga Buxheti i Unionit Evropian kontrolli në vendin e ngjarjes zbatohet në të gjitha rastet e theksuara në paragrafin 1 të këtij neni për të gjitha kërkesat e parashtruara.

Neni 30-v

Inspektorati shtetëror për bujqësi bën kontroll në vendin e ngjarjes për masat e financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, përveç masave për zhvillim rural."

Neni 23

Në nenin 32, paragrafi 1 pas fjalës "Agjencia" shtohen fjalët: "lidhur me realizimin e programeve për përkrahje financiare."

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Mbikëqyrje inspektuese të realizimit të masave nga programet për përkrahje financiare të financuara nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përveç masave për zhvillim rural, bën Inspektorati shtetëror për bujqësi ."

Neni 24

Pas nenit 34 shtohet pjesë e re XI-A si vijon: "DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE".

Neni 25

Pas nenit 34 shtohen tre nene të reja 34-a dhe 34-b dhe 34-v, si vijojnë:

"Neni 34-a

Gjobë

Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 5 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit juridik për kundërvajtje nëse nuk i kthen në afatin e përcaktuar mjetet e marra në mënyrë kundërligjore (24-a, paragrafi 2).

Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 2 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 34-b

Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 3 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit juridik për kundërvajtje nëse nuk i kthen në afatin e përcaktuar mjetet e marra në mënyrë kundërligjore (24-a, paragrafi 2).

Neni 34-v

Procedura për barazim

Para parashtrimit të kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj para gjykatës kompetente, kryerësit të kundërvajtjes, Agjencia do t'i propozojë procedurë për barazim."

Neni 26

Dispozitat nënligjore të parapara me këtë ligj do të nxirren në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".